

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

**TË DREJTAT MË TË RËNDËSISHME
PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

CILËT PERSONA KONSIDEROHEN SI PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA?

Sipas Ligjit për mbrojtje sociale, personi me aftësi të kufizuara është personi i cili ka çregullime afatgjate trupore, intelektuale, mendore apo shqisore të cilat në ndërveprim me pengesa të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të tërësishme dhe efikase në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët.

Me këtë, personat me aftësi të kufizuara mund të jenë personat me shikim të dëmtuar, dëgjim të dëmtuar, me pengesa të zërit, të folurit dhe gjuhës, personat me invaliditet trupor¹ me pengesa në zhvillimin intelektual dhe personat me pengesa të kombinuara i cili për shkak të shkallës të invaliditetit ka nevoja specifike në punë.

1 Tekstet ligjore ende operojnë me termet “invaliditet” dhe “pengesa” .

Të drejtat më të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara

CILAT TË DREJTA TË MBROJTJES SOCIALE I KAM NË DISPOZICION SI PERSON ME AFTËSI TË KUFIZUARA? SI T’I REALIZOJË?

Kompensim për shkak të pengesës

Kompensimi për shkak të pengesës sigurohet për nxitjen e përfshirjes sociale dhe mundësive të barabarta të personit që është me pengesa të rënda apo të thella intelektuale, me pengesa më të rënda trupore, person plotësisht i verbër, dhe person plotësisht i shurdhër.

Ky kompensim u takon personave prej 26 deri në 65 vjet.

E drejta në kompensim për shkak të pengesës realizohet në bazë të mendimit konziliar nga komisioni i shkallës të parë të përbërë prej tre mjekësve specialist nga enti përkatës shëndetësor terciar. Kundër mendimit të komisionit, keni të drejtë në ankesë në komisionin e shkallës të dytë.

Pas marrjes të mendimit konziliar në të cilin është vërtetuar shkalla e pengesës, dorëzohet Kërkesa për realizimin e kompensimit për shkak të pengesës deri në Qendrën për punë sociale që është kompetente për adresën tuaj. Kërkesës i bashkangjitet për këqyrje edhe letërnjoftimi i vlefshëm, mendimi konziliar origjinal apo i vërtetuar në noter dhe kopje nga llogaria juaj transaksionale.

Kompensim për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër

Kjo e drejtë i takon personit që i **ka mbushur 26 vjet, me pengesa mesatare, të rënda, apo të thella intelektuale, persona me aftësi të kufizuara trupore të rënda dhe më të rënda, person plotësisht i verbër, si dhe person me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore, të cilit i nevojitet ndihmë e domosdoshme dhe kujdes nga personi tjetër për shkak se nuk mundet vetë të kryejë aktivitetet kryesore të jetës të përditshme, nëse kjo e drejtë nuk mund të realizohet në bazë të dispozitave tjera.**

Nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër **ka edhe personi i cili për shkak të ndryshimeve të përkohshme në gjendjen shëndetësore pa ndihmën e veglave ndihmëseve ortopedike nuk mund të kryejë aktivitetet kryesore të jetës të përditshme.**





Për realizimin e kësaj të drejte, parashtrohet Kërkesë deri në Qendrën për punë sociale që është kompetente për adresën tuaj. Kërkesës i bashkangjitet për këqyrje letërnjoftimi i vlefshëm, mendimi nga mjeku amë për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, dhe letër lëshimi nga spital i specializuar, dhe dokumentacion tjetër mjekësor, nëse është e nevojshme.

Ndihma gjatë prokurimit të automjetit për udhëtarë

Persona me aftësi të kufizuara të rënda dhe më të rënda, persona me aftësi të kufizuara mesatare, të rënda dhe të thella intelektuale, personi plotësisht i verbër me shoqërues dhe personi plotësisht i shurdhër mund të parashtrojnë kërkesë për rimbursim të mjeteve të paguara si të dhëna doganore, tatimi i vlerës të shtuar dhe akciza për prokurimin e automjetit për udhëtarë.

Të drejtat më të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara

Këtë automjet për udhëtarë mund ta drejtojë parashtruesi i kërkesës apo bashkëshorti i tij, prindi, fëmija apo i afërmi tjetër i cili jeton me personin dhe ndërmjet tyre ekziston detyrimi për mbajtje në pajtim me Ligjin për familje, respektivisht kujdestari, kurse do të shfrytëzohet ekskluzivisht për nevojat e personit për transport dhe integrim më të lehtë social në bashkësi.

Kërkesa nga paragrafi **1 i këtij neni mund** të parashtrohet një herë në periudhë prej pesë vitesh për prokurimin e automjetit për udhëtarë me vlerë të shitblerjes deri në 10.000 euro në kundërvlerë në denarë, **respektivisht me vlerë të shitblerjes deri në 20.000 euro në kundërvlerë në denarë, nëse në automjet është integruar pajisja shtesë që mundëson që personi në mënyrë të pavarur të drejtojë automjetin.**

Vlera e mjeteve të cilat rimburohen për të dhënat doganore të paguara, tatimi i vlerës të shtuar dhe akciza për prokurimin e automjetit për udhëtarë, mund të jetë jetë më **së shumti deri në 180.000 denarë.**

Kërkesa për rimbursimin e mjeteve dorëzohet në Komisionin për rimbursim të mjeteve për prokurimin e automjetit për udhëtarë, përmes Qendrës për punë sociale që është kompetente për vendbanimin tuaj.

KU TË DREJTOHEM PËR PËRCAKTIMIN E LLOJIT DHE SHKALLËS TË PENGESËS?

Aktivendimin për llojin dhe shkallën e pengesës e merr Qendra për punë sociale, në bazë të gjetjes dhe mendimit nga organi që është profesional dhe i autorizuar për dhënien e gjetjes dhe mendimit nga fusha e caktuar.

Kontaktoni Qendrën për punë sociale që është kompetente për vendbanimin që t'ju udhëzojë drejtë organit përkatës për nevojën tuaj.

Pas marrjes të kësaj gjetjeje dhe mendimi, Qendra për punë sociale do të lëshojë Aktvendim me të cilin vërtetohet lloji dhe shkalla e aftësisë të kufizuar.

KU TË DREJTOHEM PËR VËRTETIMIN E AFTËSISË PËR PUNË?

Përcaktimi i aftësisë për punë bëhet nga ana e **Komisionit për aftësi të punës**, që është pjesë e Njësisë për vlerësim të aftësisë të punës në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor.

Komisioni e vërteton aftësinë tuaj për punë si një nga hapat për realizimin e të drejtës për pension familjar, të drejtën për orar të shkurtuar të punës apo e drejta për vendosje në punë tjetër përkatëse.

Nëse keni parashtruar kërkesë për shfrytëzimin e pensionit familjar, Komisioni do të sjellë dokument – Gjetje, vlerësim dhe mendim për ekzistimin e invaliditetit, për shkak të realizimit të të drejtave të sigurimit invalidor dhe paaftësisë për punë të anëtarit të familjeve.



Nëse keni parashtruar kërkesë për realizimin e të drejtës për orar të shkurtuar të punës, apo kërkesë për realizimin e të drejtës për vendosje në punë tjetër përkatëse, rikualifikim dhe kualifikim shtesë, Komisioni do të sjellë dokument – Gjetje, vlerësim dhe mendim për përcaktimin e invaliditetit për realizimin e këtyre të drejtave.

Gjatë vlerësimit të aftësisë tuaj të punës, do të ftoheni nga ana e Komisionit, kurse gjithashtu, nëse është e nevojshme, Komisioni mund të kërkojë edhe informacione dhe dokumente shtesë.

Për ta fituar të drejtën e punësimit si person sipas Ligjit për punësimin e personave me invaliditet, nevojitet të parashtroni kërkesë tek Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë, në kuadër të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, përveç nëse invaliditeti nuk është konstatuar nga ndonjë organ tjetër.

Nëse jeni mbi moshën 26-vjeçare dhe posedoni dokument për kategorinë dhe shkallën e pengesës prej para dhjetë viteve, komisioni në fjalë detyrimisht do ta përcaktojë invaliditetin gjatë punësimit tuaj të parë.

Të drejtat më të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara



CILAT JANË KUSHTET PËR MARRJEN E PENSIONIT INVALIDOR?

Pensioni invalidor i takon personit që nuk është i aftë për punë apo i cili ka aftësi të kufizuara për punë por për shkak të moshës nuk mund të rikualifikohet për punë tjetër.

Nëse pamundësia për punë është shkaktuar si rezultat i lëndimit në vendin e punës apo sëmundjes profesionale, pensioni invalidor i takon secilit, pa dallim të moshës dhe stazhit.

Nëse pamundësia për punë është shkaktuar si rezultat i lëndimit jashtë punës apo sëmundjes që nuk është sëmundje profesionale, pensioni invalidor do i takojë personit që para asaj ngjarje, apo duke përfshirë ditën kur i është ndërprerë sigurimi, i ka përmbushur këto kritere:

- ✓ Nëse është më i vjetër se 45 vjet të ketë të paktën 12 vite stazh pensional;
- ✓ Nëse është i moshës prej 37 deri në 45 vjet, të ketë stazh pensional që i mbulon 40% të karrierës;



- ✓ Nëse është i moshës prej 30 deri në 37 vjet, të ketë stazh pensional që i mbulon 30% të karrierës;
- ✓ Nëse është i moshës prej 25 deri në 30 vjet, të ketë të paktën 12 muaj stazh të sigurimit;
- ✓ Nëse është i moshës prej 20-25 vjet, të ketë të pakën 9 muaj stazh të sigurimit, dhe
- ✓ Nëse është i moshës mbi 20 vjet, të ketë të paktën 6 muaj stazh të sigurimit.

UNË JAM PRIND I FËMIJËS ME PENGESA. A MË TAKOJNË TË DREJTA APO NDIHMË E POSAÇME?

E drejtë në orar të shkurtuar punës

Në pajtim me këtë të drejtë, nëse dy prindër të të fëmijës me pengesa janë punësuar, njëri prind mund të shfrytëzojë të drejtën në orar të shkurtuar të punës. Nëse bëhet fjalë për prind të vetëm, ai prind mund të shfrytëzojë këtë të drejtë.

Kjo e drejtë do të thotë se prindi do të punojë në orar të shkurtuar të punës, por do i rrjedhë stazhi sikur të punojë në orar të plotë të punës. Punëdhënësi do i paguajë gjysmën e rrogës, ndërsa pjesën e dytë do ta pranojë si kompensim të rrogës, që është 50% nga rroga mesatare neto e prindit të paguar në vitin paraprak, apo 100% nga rroga mesatare neto për punën me orar të shkurtuar e cila i është paguar prindit në vitin paraprak. Kjo vlerë nuk mund të tejkalojë 50% nga rroga mesatare neto në shtet për vitin paraprak.

Është me rëndësi të përmendet se kjo e drejtë i takon vetëm nëse fëmija jeton në familje, respektivisht nëse fëmija nuk është akomoduar në ndonjë ent, pavarësisht të arsyes për akomodimin e tillë.

E drejta në kompensim të përleshëm për prindin që është kujdesur për fëmijën me pengesa

Kjo e drejtë i takon prindit që është kujdesur për fëmijën deri në moshën e tij 26 vjeçare, pa shfrytëzuar i njëjti mbrojtje sociale jashtë familjare, i cili është i papunë dhe nuk shfrytëzon të drejtën për pension, pas mbushjes të 62 viteve për gratë, respektivisht 64 vite për burrat.

E drejta nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të realizohet nëse prindit i është hequr e drejta prindërore mbi fëmijën.

E drejta në shtesë të veçantë

E drejta në shtesë të veçantë është kompensim në para i cili sigurohet për fëmijën me nevoja specifike që ka pengesa në zhvillimin trupor apo mendor apo pengesa të kombinuara në zhvillim deri në 26 vjet.

Kompensimi i jepet njërit prej prindërve të fëmijës.



PERSON ME PENGESA FIZIKE. A KAM TË DREJTË TË KËRKOJË NGA KOMUNA APO QYTETI IM TË MË MUNDËSOJNË LËVIZJE TË PANDËRPRERË JASHTË SHTËPISË?

Personat me pengesa i kanë të drejtat e njëjta si dhe qytetarët tjerë.

Përveç kësaj, në pajtim me Konventën për drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ne si shtet jemi të detyruar që të sigurojmë qasshmëri përkatëse të infrastrukturës të personave me aftësi të kufizuar respektivisht me pengesa.

Nëse në mjedisin tuaj nuk është mundësuar qasje, keni të drejtë që ta kërkonti atë nga komuna apo qyteti juaj.



KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	

Të drejtat më të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Drejtësisë